



REPUBLIKA E SHQIPERISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 20 Prot

Tiranë, më 10.09 2007

VENDIM Nr. 17 dt. 06.09.2007

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9592, datë 27.07.2006, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9048, dt 07.04.2003 "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 06.09.2007, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës.

VENDOSI:

I. Miratimin e projekteve:

1. Projekt restaurimi Kisha e Shën Sotirit (Sveti Spas) – Kërçisht Dibër. (Arkitekturë)
2. Projekt konservimi dhe restaurimi i mozaikut të bazilikës së Shën Mëhillit, Arapaj Durrës.
3. Projekt restaurimi, Muzeu Etnografik i Kavajës.
4. Projekt Restaurimi Bazilika Paleokristiane Gjericaj, Durrës.
5. Kalaja e Shkodrës. (Projekti i hartuar nga Parku arkeologjik i Shkodrës. Vazhdim punimesh i projektit të hartuar nga IMK dhe miratuar nga KKR.)
6. Manastiri i Shenjtorëve Pjetër dhe Pavël në Vithkuq, Korçë.

(Projekti u miratua me vërejtjet: Kokat e tirandave të jenë të padukshme, si dhe nuk u miratuan pikat:

(6- Konsolidimi i pjesëve të dëmtuara të pikturës murale

(13- Konsolidimin e pikturës murale. Për të dy pikat e sipërpërmendura duhet të hartohet projekt i veçantë).

7. Kisha e Shën Nikollës Voskopoje, Korçë.
8. Projekte të mirëmbajtjes dhe konservimit dhe pastrimit nga vegetacioni të paraqitura nga Parku Arkeologjik i Butrintit. Supervizore e projekteve të mëposhtme u caktua znj. Kozeta Angjeliu.
 - Pastrimin e vegetacionit nga Porta e liqenit deri në akropol, me qëllim vlerësimin e segmentit, të murit rrethues të Akropolit
 - Vazhdimin e projektit të menaxhimit të vegetacionit përreth Butrintit.
 - Rimbulimi i disa ambienteve të gërmuara më parë brenda territorit të Parkut.
 - Konservimin dhe përmirësimin e territorit përreth portës së ujit, Butrint.
 - Pastrimin e vegetacionit, vlerësimin dhe konservimin e Nekropolit Romak, pranë pusit të Junia Ruffinës.
 - Heqjen e pemëve dhe menaxhimin e vegetacionit, kombinuar me një program vlerësimi dhe konservimi për murin rrethues përgjatë kanalit të Vivarit, Butrint.
 - Menaxhimi i pemëve dhe konservimi i kullës në Juglindje të pallatit të Trikonkës.
 - Menaxhimin e vegetacionit dhe konservime minimale në Kalanë Trekëndore, pranë Kanalit të Vivarit.
 - Rimbulim, konservim dhe prezantimin e zonës së forumit Romak Butrint.
 - Konservimin, rimbushjen dhe prezantimin e kullës mbrojtëse pranë Portës së

Ujit, Butrint.

- Konservim, rimbullim dhe prezantim të disa monumenteve në Fushën e Vrinës.
 - Menaxhimin e vegjetacionit dhe konservimin e Bazilikës së Akropolit.
 - Panel interpretues, për zonën e Forumit Butrint.
9. Restaurimi i manastirit të Shën Mërisë, Kakome, Sarandë. (U miratuan ndërhyrjet në arkitekturë. Duhet të hartohet projekt i veçantë për konservimin e pikturës murale).
 10. Konservimi dhe rrethimi i Mozaikut të kishës Paleokristiane Antigone, Gjirokastër. (Projekti u miratua me shënimin: punimet të kryhen duke u larguar nga strukturat).
 11. Ndërtimi i godinës shumë funksionale në Parkun Arkeologjik Antigone, Gjirokatër. (Të hartohet një projekt në bashkëpunim me IMK. Godina duhet të jetë 1 kat dhe me strukturë të lehtë, druri).
 12. Lidhur me problematikën e objekteve të Durrësit, të caktohet një grup i përbashkët përfaqësuesish midis Institutit të Arkeologjisë dhe Institutit të Monumenteve të Kulturës, të cilët do të sjellin propozime konkrete për monumente të veçanta.

II. Nuk u miratuan projektet

1. Rikonstrukcion, banesa Mihal Gërço, lagja Kala, Elbasan.
2. Projekt rikonstrukcion banese, Ylli Trajçe, Korçë.
3. Projekt rikonstrukcion shtesë kati, dhe anësore banese me ambiente shërbimi, Demir Liçenji Korçë.

III. U miratuan propozimet për shpalljen monument kulture

1. Shpallje monument kulture. (Vila POLENA), Korçë.
2. Shpallje monument kulture, Kisha e Shën Dhimitrit në Kërçisht të rrethit të Dibrës.
3. Shpallje monument kulture, Kafja e madhe Shkodër

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
PROF. DR. YLLI PANGO

SEKRETAR I K.K.R.

LORENC BEJKO